

Kapitulli 4

Të ardhurat

Objektivat e kapitullit

Në përfundim të këtij kapitulli, ju do të keni mundësi të:


- Diskutoni dhe zbatoni modelin pesë-hapësh lidhur me të ardhurat e fituara nga kontratat me klientin
- Diskutoni dhe zbatoni kriterin që duhet të plotësohet përpara se njësi ekonomike të zbatojë modelin e njohjes së të ardhurave për kontratën.



E drejta e autorit dhe Përkthimi

Materiali Paper P2, Corporate Reporting (CR), ACCA, i publikuar nga KAPLAN në gjuhën angleze, është përkthyer në gjuhën shqipe nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë (IEKA) dhe përdoret me lejen e KAPLAN. KAPLAN nuk mban përgjegjësi për saktësinë dhe plotësinë e përkthimit ose për veprimet që mund të rrjedhin prej tyre. Teksti i aprovuar i të gjitha publikimeve të KAPLAN është teksti që KAPLAN ka publikuar në gjuhën angleze.

Përkthyer në Shqip në pajtim me politikën e përkthimit të KAPLAN nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar.



1. Të ardhurat nga kontratat me klientët (SNRF 15)

Të ardhurat janë rritje në përfitimet ekonomike nga aktivitetet e zakonshme të njësisë.

- Me aktivitete të zakonshme do të nënkuptojmë aktivitetet normale tregtare apo operative.
- “Të ardhurat” e paraqitura nëpasqyrën e fitimit ose humbjes nuk duhet të përfshijnë zëra si shumat e mjeteve monetare të marra nga shitja e aktiveve afatgjata apo taksat mbi shitjen.

2. Njohja e të ardhurave

Nje proces me pesë hapa

Sipas SNRF 15 “Të ardhurat nga kontratat me klientët” (Versioni INT), njësia ekonomike do të njohë të ardhurat e realizuara nëpërmjet zbatimit të pesë hapave si më poshtë:

- 1) Identifikimi i kontratës
- 2) Identifikimi i kushteve të veçanta të një performace në një kontratë
- 3) Përcaktimi i çmimit të transaksionit
- 4) Shpërndarja e çmimit të transaksionit sipas kushteve të performacës në kontratë
- 5) Njohja e të ardhurave kur një kusht performace është plotësuar.

Këto pesë hapa do të trajtohen në vijim në mënyrë të detajuar. Megjithatë, shembujt në vijim do t’ju ndihmojnë për të kuptuar më mirë parimet bazë të modelit për njohjen e të ardhurave të SNRF 15.

Shembulli 1 – Pesë hapat

Në 1 Dhjetor 20X1, Wade merr një porosi nga një klient për një kompjuter si dhe mbështetje teknike për 12 muaj. Wade dorëzon produktin (dhe transferon titullit ligjor) tek klienti në të njëjtën ditë.

Klienti pagoi një vlerë fillestare prej \$420. Nëse do të shiten më vetë, atëherë çmimi i shitjes së kompjuterit është \$300 dhe çmimi i shitjes për mbështetjen teknike është \$120.

Kërkohet:

Zbatoni 5 fazat e njohjes së të ardhurave, sipas SNRF 15, për të përcaktuar vlerën me të cilën fazë do të njohë të ardhurat për vitin që mbyllet në 31 Dhjetor 20X1.

Zgjidhje

Hapi i I – Identifikimi i kontratës

Ekziston një marrëveshje ndërmjet Wade dhe klientit të tij për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve.

Hapi i II- Identifikimi i kushteve të veçanta të një performace në një kontratë

Ekzistojnë dy kushte të performacës (premtime) në kontratë:

- Furnizimi me një kompjuter
- Furnizimi i mbështetjes teknike.

Hapi i III- Përcaktimi i çmimit të transaksionit

Çmimi total i transaksionit është \$420.

Hapi i IV- Shpërndarja e çmimit të transaksionit kundrejt kushteve të performacës në kontratë

Bazuar në çmimet specifike të shitjes, \$300 duhet të shpërndahen për shitjen e kompjuterit dhe \$120 duhet të shpërndahen për mbështetjen teknike.

Zgjidhje

Hapi i V – Njohja e të ardhurave kur një kusht performace është plotësuar

Kontrolli mbi kompjuterin është transferuar tek klienti, kështu që të ardhurat e plota prej \$300 të shpërndara për furnizimin e kompjuterit duhet të njihen më 1 Dhjetor 20X1.

Mbështetja teknike sigurohet përgjatë një periudhe të caktuar, kështu që të ardhurat për të duhet të njihen përgjatë kohës. Në vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 20X1, e ardhura prej \$10 (1/12 x \$120) duhet të njihet nga dhënia e shërbimeve teknike.

Në vijim do të trajtohen në mënyrë më të detajuar pesë hapat për njohjen e të ardhurave.

Hapi I: Identifikimi i kontratës

Sipas SNRF 15, kontrata është një marrëveshje midis dy palëve që krijon të drejta dhe detyrime. Një kontratë nuk është e nevojshme që të jetë e shkruar.

Një njësi ekonomike mund të trajtojë të ardhurat nga kontrata vetëm nëse plotësohen kriteret e mëposhtme:

- Palët në kontratë e kanë miratuar atë dhe secila palë mund të identifikohet
- Kushtet e pagesës janë të identifikueshme
- Kontrata ka thelb tregtar
- Ka propabilitet të lartë që njësi ekonomike do të paguhet.

Kontrata

Aluna ka një biznes viti i të cilës mbyllet në 31 Dhjetor 20X1.

Më 30 Shtatort 20X1, Aluna nënshkroi një kontratë me një klient për të pajisur me një aktiv më 31 Dhjetor 20X1. Kontrolli mbi aktivin u transferua klientit më 31 Dhjetor 20X1. Klienti do të paguajë \$1m më 30 Qershor 20X2.

Për shkak të ndryshimeve në mjedisin ekonomik, Aluna nuk beson se do të jetë e mundur që deri më 31 Dhjetor 20X1 të arkëtojë shumën korresponduese për të cilën ajo gëzon të drejtën.

Hapi II - Identifikimi i kushteve të veçanta të një performace në një kontratë

Kushtet e performacës janë pretime për të transferuar mallra apo shërbime të dallueshme.

Disa kontrata përmbajnë më shumë se një kusht performance. Për shembull:

- Një entitet mund të lidhë një kontratë me një klient për shitur një makinë, e cila përfshin një tarifë njëvjeçare shërbimi dhe mirëmbajtjeje.
- Një entitet mund të lidhë një kontratë me një klient për të siguruar pesë seanca leksionesh, si dhe tekstet shkollore në ditën e parë të kursit.

Kushtet e dallueshme të performacës në një kontratë duhet të jenë të identifikueshme. Nëse mallrat apo shërbimet zakonisht shiten më vete, atëherë furnizimi i tyre ka mundësi që të krijojë kushte performance të dallueshme nëse përfshihen në të njëjtën kontratë.

Garancitë

Në të shumtën e rasteve, garancia është një siguri që produkti do të funksionojë sipas synimit të tij. Në këtë rast, garancia do të trajtohet në përputhje me SNK 37 Provizionet Detyrimet e Kushtëzuara dhe Aktivitetet e Kushtëzuara.

Nëse klienti ka opsionin për të blerë garancinë më vetë, atëherë ai duhet të trajtohet si një kusht i dallueshëm i performancës. Kjo nënkupton që duhet t'i shpërndahet një pjesë e çmimit të transaksionit.

Shumat kryesore kundrejt shumave të agjentit

Një njësi ekonomike duhet të përcaktojë natyrën e secilës kusht të performacës. Sipas SNRF 15 (para. B34) entiteti mund:

- të ofrojë vetë mallrat ose shërbimet e specifikuar (d.m.th. njësi ekonomike është njësi kryesore), apo
- të zgjedhë një palë të tretë për të ofruar mallrat apo shërbimet (d.m.th. njësi ekonomik është njësi agjent)

Nëse njësi ekonomike është njësi ekonomik agjent, atëherë të ardhurat do të njihen bazuar në tarifat apo komisionet për të cilat gëzon të drejtat.

Hapi III - Përcaktimi i çmimit të transaksionit

SNRF 15, përcakton çmimin e transaksionit si shumën korresponduese të cilën njësi ekonomike pret në këmbim të plotësimin të një kushti performance. Përjashtohen taksat mbi shitjen.

Në përcaktimin e çmimit të transaksionit, njësi ekonomike duhet të marrë në konsideratë:

- shumat korresponduese të ndryshueshme
- përbërësit financues të rëndësishëm
- shumën korresponduese jo monetare
- shumën korresponduese të pagueshme ndaj klientit

Shuma korresponduese e ndryshueshme

Nëse një kontratë përfshin shumën korresponduese të ndryshueshme, atëherë njësi ekonomike duhet të vlerësojë shumën për të cilën ajo do të ketë të drejtë.

Sipas SNRF 15, vlerësimi i shumës korresponduese të ndryshueshme mund të përfshihet në çmimin e transaksionit vetëm nëse ka shumë mundësi që zgjidhja e mëpasshme e pasigurisë nuk do të sjellë anulim të rëndësishëm të shumës së të ardhurave të akumuluar të njohura.

Testoni njohuritë tuaja 1 - Bristow

Më 1 Dhjetor 20X1, Bristow siguron për klientin e tij një shërbim për 12 muajt e ardhshëm. Shuma korresponduese është \$12 milion. Pas 12 muajve, Bristow ka të drejtën për të kërkuar \$3 milion të tjerë nëse numri i gabimeve të bëra bie nën një kufi të caktuar.

Kërkohe:

Diskutoni trajtimin kontabël të veprimeve të mësipërme në pasqyrat financiare të Bristow për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 20X1 nëse:

- a) Bristow ka eksperiencë të mëparshme në ofrimin e shërbimeve të njëjta dhe nëse ka shumë mundësi që numri i gabimeve të bëra të bjerë nën kufirin e pranueshëm.
- b) Bristow nuk ka eksperiencë të mëparshme në ofrimin e këtij shërbimi dhe është i pasigurtë nëse numri i gabimeve të bëra do të bjerë nën kufirin e caktuar.

Rimbursimet

Nëse një produkt është shitur me të drejtë rikthimi atëherë shuma korresponduese është e ndryshueshme. Njësia ekonomike duhet të vlerësojë shumën korresponduese të ndryshueshme dhe të vendosë nëse duhet ta përfshijë ose jo në çmimin e transaksionit.

Detyrimi i rimbursimit duhet të jetë e barabartë me shumën korresponduese të arkëtuar (ose të arkëtueshme) për të cilat njësia ekonomike nuk pret të këtë të drejtë.

Shembull: Rimbursimet

Nardone lidh 50 kontrata me klientët e tij. Secila kontratë përfshin shitjen e një produkti prej \$1000. Për Nardone kostot për secilin produkt janë \$400. Mjetet monetare paguhen në fillim dhe kontrolli i produktit transferohet pasi produkti është dorëzuar. Klientët mund të kthejnë produktin brenda 30 ditëve për të përfituar një rimbrusim të plotë. Nardone mund të shesë produktet e kthyer me fitim.

Nardone ka eksperiencë të konsiderueshme në vlerësimin e kthimeve për këtë produkt. Llogaritet që 48 produkte nuk do të kthehen.

Kërkohe:

Si do të trajtohet transaksioni i mësipërm?

Zgjidhje

Fakti që klienti mund të kthejë produktin do të nënkuptojë që shuma korresponduese është e ndryshueshme.

Duke përdorur një metodë të vlerës së pritur, shuma korresponduese e ndryshueshme e vlerësuar është \$48000 (48 produkte x \$1000). Kjo shumë korresponduese e ndryshueshme duhet të përfshihet në çmimin e transaksionit sepse bazuar në eksperiencën e Nardome, ka shumë mundësi që të mos ndodhë një anulim i rëndësishëm i shumës së të ardhurave të akumuluar të njohura (\$48000).

Si rrjedhojë, duhet të njihet një ardhur prej \$48000 dhe një detyrim për rimbursim prej \$2000 (\$1000 x 2 produkte që pritet të kthehen).

Nardone do të çregjistrojë inventarin e transferuar tek klientët e saj. Ajo duhet të njohë një aktiv për \$800 (2 produkte x \$400), si dhe një shumë korresponduese të kreditimit të kostos së shitjes, për të drejtën e saj për të rimarrë produktet nga klientët për shlyerjen e detyrimit të rimbursimit.

Financimi

Në përcaktimin e çmimit të transaksionit, njësia ekonomike duhet të marrë në konsideratë nëse koha e pagesave i ofron klientit apo njësisë ekonomike përfitime nga financimi.

Nëse ka një përbërs financues, atëherë shumat korresponduese të arkëtueshme duhet të zbriten nga vlera aktuale duke përdorur normën me të cilën klienti merr hua paratë.

Tregues të një përbërsi financues

SNRF 15 jep treguesit në vijim të një përbërsi financues të rëndësishëm:

- diferenca mes shumës korresponduese të premtuar dhe çmimit të shitjes me para në dorë të mallrave apo shërbimeve të premtuara
- intervali kohor mes momentit kur njësia ekonomike transferon mallrat apo shërbimet e premtuara tek klienti dhe momentit kur klienti paguan për këto mallra apo shërbime

Testoni njohuritë tuaja 2 - Rudd

Rudd lidh kontratën më një klient për shitjen e paisjeve më 31 Dhjetor 20X1. Kontrolli i paisjeve i transferohet klientit në të njëjtën datë. Çmimi i shprehur në kontratë është \$1 milion dhe pagesa duhet të bëhet më 31 Dhjetor 20X3.

Normat e interesit të disponueshëm në treg për këtë klient janë 10%.

Kërkohet:

Shpjegoni si duhet të trajtohet ky transaksion në pasqyrat financiare të Rudd për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 20X1.

Shuma korresponduese jo monetare

Çdo shumë korresponduese jo monetare matet me vlerën e drejtë.

Nëse vlera e drejtë e shumës korresponduese jo monetare nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme, atëherë transaksioni matet duke përdorur çmimet specifike të shitjes të mallrave apo shërbimeve të premtuara për klientin.

Testoni njohuritë tuaja 3 – Dan dhe Stan

Dan i shet mallra Stan. Kontrolli i mallrave transferohet më 1 Janar 20X1. Shuma korresponduese e arkëtuar nga Dan është 1000 aksione të Stan me një vlerë të drejtë prej \$4 për aksion. Deri më 31 Dhjetor 20X1, aksionet e Stan kanë një vlerë të drejtë prej \$5 për aksion.

Kërkohet:

Me çfarë vlerë do të njihen të ardhurat nga ky transaksion në pasqyrat financiare të Dan për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 201X?

Shuma korresponduese e pagueshme tek klienti

Nëse shuma korresponduese i paguhet klientit në këmbim të një malli apo shërbimi specific (të dallueshëm), atëherë duhet të trajtohet si një transaksion blereje.

Nëse shuma korresponduese që i paguhet klientit nuk është në këmbim të një malli apo shërbimi specific (të dallueshëm), njësia ekonomike duhet ta trajtojë atë si një pakësim të çmimit të transaksionit.

Testoni njohuritë tuaja 4 – Golden Gate

Golden Gate lidh një kontratë me një zinxhir të madh të pikave të shitjes me pakicë. Klienti merr përsipër që të blejë të paktën \$20m në produkte përgjatë 12 muajve të ardhshëm. Kushtet e kontratës kërkojnë që Golden Gate të kryejë një pagesë prej \$1m për të kompesuar klientin lidhur me ndryshimet që duhet të bëjë në pikat e shitjes me shumicë për të magazinuar produktin.

Deri më 31 Dhjetor 20X1, Golden Gate ka transferuar tek klienti produkte me një vlerë prej \$4m.

Kërkohet:

Sa është vlera e të ardhurave të njohura nga Golden Gate për vitin që mbyllet më 31 Dhjetori 20X1?

Hapi IV -Shpërndarja e çmimit të transaksionit

Çmimi total i transaksionit duhet të shpërndahet për çdo kusht performance në përpjestim me çmimet specifike të shitjes.

Treguesi më i mirë i çmimit specifik të shitjes është çmimi i vrojtueshëm i mallit apo shërbimit kur njësia e shet atë mall apo shërbim veçmas.

Nëse çmimi specifik i shitjes nuk është i vrojtueshëm drejtpërdrejt, atëherë ajo duhet të vlerësohet nga njësia ekonomike. Inputet e vrojtueshme duhet të maksimizohen sa herë që është e mundur.

Nëse klientit i ofrohet një skonto për blerjen e një grupi mallrash dhe shërbimesh, atëherë skontoja duhet të shpërndahet në të gjitha kushtet e performacës në kontratë, në përpjestim me çmimet e tyre specifike të shitjes (përveçse në rastet kur nga evidenca e vrojtueshme sugjerohet se do të ishte e pasaktë).

Testoni njohuritë tuaja 5 – Shred

Shred shet një makineri sëbashku me suportin teknik për një vit me një vlerë prej \$100,000. Shitja e makinerisë dhe provizioni për suportin teknik janë identifikuar veçmas si kushte performance. Shred zakonisht e shet makinerinë për \$95000 por nuk ka filluar akoma të shesë suportin teknik për këtë makineri si një produkt specifik më vete. Shërbime të tjera të mbështetjes të ofruara nga Shred kanë një kosto shtesë prej 50%. Pritet që kostot e Shred për suportin teknik të jenë në vlerën prej \$20000.

Kërkohet:

Sa është shuma e çmimit të transaksionit që duhet të shpërndahet tek makineria dhe tek suportin teknik?

Hapi V - Njohja e të ardhurave

Njësia ekonomike do të njohë të ardhurat kur të plotësojë (ose në masën që plotëson) kushtin e performancës duke transferuar mallin apo shërbimin e premtuar tek klienti.

Njësia ekonomike duhet të përcaktojë në krijimin e kontratës nëse kushti i performancës do të plotësohet përgjatë kohës ose në një moment të caktuar kohor.

Sipas SNRF 15 (para. 35), njësia ekonomike plotëson kushtin e performances përgjatë kohës nëse plotësohet një prej kritereve në vijim:

- a) klienti merr dhe konsumon njëkohësisht përfitimet e ofruara nga njësia ekonomike në masën e realizuar nga kjo e fundit
- b) aktiviteti i njësisë ekonomike krijon ose përmirëson një aktiv (për shembull prodhimi në proces) të cilin klienti e kontrollon ndërkohë që aktivi krijohet ose përmirësohet; ose
- c) aktiviteti i njësisë ekonomike nuk krijon ndonjë aktiv që mund të përdoret ndryshe dhe njësia ekonomike ka një të drejtë të ekzekutueshme me forcë për t'u paguar lidhur me performancën e realizuar deri në atë datë.

Nëse një kusht performance plotësohet përgjatë kohës, atëherë të ardhurat do të njihen përgjatë kohës bazuar në progresin për plotësimin e atij kushti performace.

Testoni njohuritë tuaja 6 – Evans

Më 1 Janar 20X1, Evans lidh një kontratë me një klient për të ofruar shërbimet mujore e përgatitjes së listëpagesave. Evans i ngarkon klientit një tarifë prej \$120000 në vit.

Kërkohe:

Cili është trajtimi kontabël për situatën e mësipërme në pasqyrat financiare të Evans për vitin që mbyllet më 30 Qershor 20X1.

Testoni njohuritë tuaja 7 – Crawford

Në 31 Mars 20X1, Crawford lidh kontratën me një klient për ndërtimin e një fabrike të specializuar. Në fillim të kontratës, klienti paguan një depozitë e cila është e rimbursueshme vetëm në qoftë se Crawford nuk arrin të realizojë ndërtimin në të njëjtën linjë me kontratën. Pjesa e mbetur e çmimit është e pagueshme kur klienti merr në dorëzim fabrikën. Nëse klienti zgjidh kontratën para mbarimit të fabrikës, Crawford ka të drejtën të mbajë vetëm vlerën e depozitës fillestare.

Kërkohet:

A duhet Crawford të njohë të ardhura përgjatë kohës ose në një moment të caktuar kohor nga transaksioni i mësipërm?

Metodat për matjen e progresit për plotësimin e kushtit të performancës përfshijnë:

- Metodat output (si studimet e performacës ose koha e kaluar)
- Metodat input (si kostot e ndodhura kundrejt kostove totale të ndodhura)

Nëse progresi nuk mund të matet në mënyrë të besueshme atëherëtë ardhurat do të njihen në masën e kostove të rikuperueshme të ndodhura.

Testoni njohuritë tuaja 8 – Baker

Në 1 Janar 20X1, Baker lidh një kontratë me një klient për të ndërtuar një ndërtesë të specializuar për një shumë korresponduese prej \$2m plus një bonus prej \$0.4m nëse ndërtesa përfundohet brenda 18 muajve. Kostot e ndërtimit vlerësohen në \$1.5m. Nëse kontrata zgjidhet nga ana e klientit, Baker mund të kërkojë pagesën e kostove të ndodhura deri në momentin e zgjidhjes së kontratës si dhe një kosto shtesë prej 30%. Më 1 Janar 20X1, si pasojë e faktorëve jashtë kontrollit të tij, si kushtet atmosferike dhe entet rregullatore, Baker nuk është i sigurtë nëse do të arrihet bonusi.

Më 31 Dhjetor 20X1, Baker nuk është akoma i sigurtë nëse objektivi i bonusit do të plotësohet. Baker vendos që të vlerësojë progresin për plotësimin e kushtit bazuar në kostot e ndodhura. Kostot e ndodhura në kontratë deri në këtë moment janë \$0.1m.

Kërkohet:

Si duhet ta trajtojë Baker këtë transaksion për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 20X1?

Nëse një kusht performance nuk plotësohet pargjatë kohës atëherë do të plotësohet në një moment të caktuar kohor. Njësia ekonomike do të përcaktojë momentin e caktuar kohor në të cilën klienti siguron kontrollin e aktivitetit të premtuar.

Njësia ekonomike kontrollon aktivin nëse mund të përdorë drejtpërdrejtë aktivin dhe të marrë të gjitha (thujtë) përfitimet e mbetura të tij. Kontrolli gjithashtu përfshin aftësinë për të penguar njësitë e tjera ekonomike të marrin përfitime nga aktiviteti.

SNRF 15 (para 38) trajton treguesit në vijim për transferimin e kontrollit:

- Njësia ekonomike ka një të drejtë aktuale për t'u paguar për aktivitetin
- Klienti mban titullin ligjor për aktivitetin
- Njësia ekonomike ka transferuar zotërimin fizik të aktivitetit
- Klienti ka rreziqe dhe përfitime të rëndësishme nga pronësia e aktivitetit
- Klienti ka pranuar aktivitetin

Testoni njohuritë tuaja 9 – Clarence

Në 31 Dhjetor 20X1, Clarence i dorëzoi një rrjetë supermarketesh botimin e muajit Janar të një reviste (me vlerë totale të shitjeve prej \$100000). Titulli ligjor i mbetet Clarence deri në moment që supermarketi e shet revisten tek konsumatori final. Supermarketi do të fillojë shitjen e revistës më 1 Janar 20X2. Çdo revistë e pashitur nga supermarketi deri në 31 Janar 20X2 i kthehet Clarence.

Supermarketi do të faturohet nga Clarence më Shkurt 20X2 bazuar në diferencën mes numrit të revistave të marra dhe numrit të revistave të kthyera.

Kërkohet:

A duhet që Clarence të njohë të ardhura nga transaksionet e mësipërme për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 20X1?

3. Kostot e kontratave

Sipas SNRF 15, duhet të kapitalizohen kostot e mëposhtme:

- Kostot për marrjen e një kontrate. Duhet të përjashtohen kostot që do të ndesheshin pavarësisht nëse kontrata do të merrej apo jo (të tilla si tarifatat ligjore, ose kostot e udhëtimit tek një tender).
- Kostot e realizimit të njëkontrate nëse janë brenda objektit të një standardi tjetër (si SNA 2 Inventarët) dhe njësia ekonomike pret që ato të mbulohen.

Kapitalizimi i kostove të marrjes dhe realizimit të një kontratë do të amortizohen në pasqyrën e fitim ose humbjes pasi të njihen të ardhurat.

4. Paraqitja në pasqyrën e pozicionit financiar

Kur një njësi ekonomike ka njohur të ardhurat përpara marrjes së shumës korresponduese, atëherë duhet të njohë një të ardhur midis:

- Një llogarie të arkëtueshme, nëse të drejtat lidhur me shumën korresponduese janë pakushtëzuara; ose
- Një aktiv kontrate.

Njësia ekonomike ka të drejta të pakushtëzuara për të marrë shumën korresponduese nëse për ta konsideruar të detyrueshme për t'u paguar mjafton vetëm kalimi i kohës.

Një detyrim kontrate do të njihet nëse njësia ekonomike ka marrë shumën korresponduese (ose ka të drejta të pakushtëzuara për të marrë shumën korresponduese) përpara njohjes së të ardhurave përkatëse.

5. Çështje të tjera

Shënimet shpjeguese në lidhje me të ardhurat

SNRF 15 kërkon që njësia ekonomike të japë informacion shpjegues në lidhje me:

- Të ardhurat e njohura nga kontratat me klientët
- Tepriat e kontratës dhe aktivet e njohura nga kostot e ndodhura për marrjen apo realizimin e një kontrate
- Gjykimet e rëndësishme të bëra dhe ndryshimet në gjykime.

SNRF 15 dhe gjykimet

Gjykimi i drejtimit kërkohet përgjatë pesë hapave të njohjes së të ardhurave. Për shembull:

- Kontratat me klientet nuk janë të nevojshme të jenë formë të shkruar por mund të krijohen përgjatë aktiviteteve të zakonshme të biznesit. Si rrjedhojë, njësia ekonomike duhet të përcaktojë nëse ka një detyrim kontraktual për të dorëzuar tek klienti mallin apo shërbimin.
- Një kontratë mund të trajtohet vetëm nëse është e mundur që njësia ekonomike të mbledhë shumën korresponduese për të cilën ajo ka të drejtë. Mundësia për realizimin e përfitimeve është një gjykim.
- Njësia ekonomike duhet të identifikojë kushtet specifike (të dallueshme) të performancës në një kontratë. Megjithatë, performancat e kaluara mund të krijojnë pritshmerinë tek klienti që mallrat apo shërbimet që nuk janë specifikuar në kontratë do të transferohen. Si rrjedhojë, identifikimi i kushteve specifike (të dallueshme) të performancës varet nga gjykimi i drejtimit lidhur me kushtet e kontratës dhe ndikimin e sjelljes së kaluar të njësisë ekonomike në pritshmëritë e klientit.
- Shuma korresponduese e ndryshueshme duhet të përfshihet në çmimin e transaksionit nëse ka shumë mundësi që zgjidhja e mëpasshme e pasigurisë lidhur me shumën e ndryshueshme nuk do të sjellë anulim të rëndësishëm të shumës së të ardhurave të akumuluar të njohura. Kjo mund të përfshijë kryerjen e gjykimeve lidhur me plotësimin e objektivave të performancës.
- Çmimi i transaksionit duhet të shpërndahet kundrejt kushteve specifike (të dallueshme) të performancës, bazuar në çmimet specifike të vrojtueshme të shitjes. Megjithatë nëse çmimet e vrojtueshme nuk janë të mundshme, atëherë duhet të përdoren teknikat e vlerësimit.
- Nëse një kusht performance plotësohet përgjatë kohës, njohja e të ardhurave bëhet bazuar në progresin e plotësimit të kushteve të performancës. Ka mënyra të ndryshme për matjen e plotësimit, siç është përdorimi i metodave input ose output, si dhe njësia ekonomike duhet të përcaktojë cila përfaqëson transaksionin në mënyrë më të drejtë.
- Nëse kushti i performancës plotësohet në një moment të caktuar kohor, njësia ekonomike duhet të përdorë gjykimin për të përcaktuar datën në të cilën kontrolli i aktivitetit ka kaluar klientit.

Këto gjykime rritin rrezikun që drejtimi i një njësie ekonomike të mund të manipulojë fitimin e saj. Si rrjedhojë zbatimi i kodit të etikës së IEKAs ka një rëndësi të madhe.

6. Përmbledhje e kapitullit

Një model pesëhapësh për njohjen e të ardhurave:

- 1) Identifikimi i kontratës
- 2) Identifikimi i kushteve të performacës
- 3) Përcaktimi i çmimit të transaksionit
- 4) Shpërndarja e çmimit të transaksionit
- 5) Njohja e të ardhurave

Kostot e kontratave

Kapitalizimi i kostove të realizimit të kontratës

Paraqitja në pasqyrën e pozicionit financiar:

Aktiv kontrate

Detvrim kontrate

Shënimet shpjeguese